



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2022

Nr. 166

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E DENONCIMIT TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA
DEMOKRATIKE”, NDAJ BASHKISË RROGOZHINË”, PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 19 Maj 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

Kërkues: Partia Demokratike

Objekti: Emërime të përkohshme në Bashkinë Rrogozhinë në kundërshtim me kufizimet e Kodit Zgjedhor

Ndaj: Bashkisë Rrogozhinë

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2 dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, si dhe nenet 60, 61 dhe



Data: 19 Maj 2022
Nr. 166

“Për shqyrtimin e denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, ndaj bashkisë Rrogozhinë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata, gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi paraprak

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë mbledhjes së datës 14.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është administruar një denoncim nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, me objekt “Emërim i përkohshëm në punë”, për shkelje të parashikuar në pikën 3, të nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe në shkronjën “d”, nën-pika 1.3, pika 1, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
2. Në denoncimin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” pretendohet se: *“Ne dispozicion të Partisë Demokratike është vënë lista me emrat e 29 personave, të cilët janë punësuar më datë 25 Janar 2022, në bashkinë Rrogozhinë, për një periudhë 3 (tre) mujore, punësim sezonal i tyre. Punësimi është kryer pas dekretimit të datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Këto punësime janë kryer për qëllime të posaçme elektorale në funksion të manipulimit apo ndikimit të vullnetit të zgjedhësve në këto zgjedhje.”*
3. Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
 - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njih shprehimisht Rregullatorit apo KAS-it.



4. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

5. Referuar denoncimit të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 883 prot., datë 14.02.2022, ka kërkuar informacion nga bashkia Rrogozhinë, në lidhje me pretendimet e denoncuesit si dhe vënien në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të të gjitha akteve përkatëse që justifikojnë vendimet e marra nga bashkia Rrogozhinë. Me shkresën nr. 614/1 prot., datë 17.02.2022, administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1046 prot., datë 18.02.2022, z. Edison Memolla, në cilësinë e kryetarit të bashkisë Rrogozhinë, ka sqaruar se:
“Bashkia Rrogozhinë nuk ka kryer punësime më datë 25 Janar 2022, nisur nga njoftimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në të cilën parashikoheshin temperatura të ulta për ditët në vijim, ku i kërkohej bashkisë Rrogozhinë, marrja e masave për përballimin e situatave si pasojë e kushteve të vështira të motit, me qëllim rritjen e gatishmërisë dhe marrjen e masave paraprake. Bashkia Rrogozhinë në datat 20 dhe 21 Janar 2022, ka kryer 27 (njëzetë e shtatë) punësime të përkohshme, marrëdhënia financiare e të cilëve, është ndërpre, që prej datës 5 Shkurt 2022. Pra ndryshe nga sa pretendohet, nuk janë punësime 3 (tre) mujore për qëllime të posaçme elektorale, por janë punësime sezonale të përkohshme vetëm për përballimin e situatës së emergjencës së dimrit. Bashkia Rrogozhinë, nga data 25 e në vazhdim nuk ka kryer asnjë punësim.”
6. Bashkëlidhur shkresës në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është vënë:
 - Kopje e kërkesës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrje masash paraprake dhe gatishmërie;
 - Kërkesa e marrjes së masave për përballimin e situatës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse;
 - Kopje të akteve të miratimit.
7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vijim të procesit të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithëanshëm, me shkresën nr. 1071 prot., datë 19.02.2022, i përcjell për njohje kryetarit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, shkresën nr. 614/1 prot., datë 17.02.2022, të bashkisë Rrogozhinë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1173 prot., datë 23.02.2022, ju përcjell për njohje palëve në proces gjetjet e denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” ndaj bashkisë Rrogozhinë, si dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9 datë 6.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, subjekti zgjedhor “Partia

Demokratike” dhe bashkia Rrogozhinë, janë njoftuar për të depozituar prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.

8. Brenda afatit të përcaktuar ligjor asnjë nga palët në proces nuk depozitoi prapësime në lidhje me denoncimin, në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1731 prot., datë 11.03.2022, në përputhje me përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 15 Mars 2022, ora 11:30, me palë Partia Demokratike dhe bashkia Rrogozhinë.
9. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” me përfaqësues të tij z. Marash Logu si dhe përfaqësues të bashkisë Rrogozhinë zj. Elona Kaçani dhe zj. Edlira Ramaj.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkoi përfaqësuesit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, të parashtrijë pretendimet e tij në lidhje me denoncimin. Në shpjegimet e tij z. Logu konfirmoi edhe njëherë denoncimin e bërë në seancë publike duke shtuar si provë të re listën me emrat e 44 punonjësve të punësuar në bashkinë Rrogozhinë si dhe kërkoi sqarim nga pala tjetër në lidhje me pyetjet:

1. A rezultojnë ende të punësuar 44 personat e punësuar me kohë sezonale në bashkinë Rrogozhinë?
 2. Data e fillimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës të secilit prej të punësuarve?
 3. Kontratat e Punës për secilin të punësuar.
 4. Vërtetimet për pagesat e përfituara nga këta punonjës.
 5. Nëse këta punonjës kanë qenë të punësuar më përpara në bashkinë Rrogozhinë.
 6. Kriteret që janë përdorur në përzgjedhjen e tyre dhe procedura e rekrutimi.
 7. Marrëdhënia që ka kryetari i bashkisë me dy punonjës z. Besnik Memolla dhe z. Gëzim Memolla.
 8. Detyrat që kanë mbuluar këta punonjës në bashkinë Rrogozhinë.
10. Përfaqësuesit e bashkisë Rrogozhinë, depozituan në seancë dëgjimore prapësimet e tyre me shkrim në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, duke i qëndruar shpjegimeve të dhëna me shkrim gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke pohuar edhe njëherë se bashkia Rrogozhinë nuk ka kryer punësime më datë 25 Janar 2022. Nisur nga njoftimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në të cilën parashikoheshin temperatura të ulëta në ditët në vijim, për të cilën i kërkohesh bashkisë marrja e masave për përballimin e situatave si pasojë e kushteve të vështira të motit, me qëllim rritjen e gatishmërisë dhe marrjen e masave paraprake, më datat 20 dhe 21 Janar 2022 janë kryer 27 punësime të përkohshme, marrëdhënia financiare e të cilëve është ndërprerë që më datë 5 Shkurt 2022. Punësimet në fjalë janë bërë vetëm për qëllime emergjence dhe nuk kanë asnjë ndikim elektoral pasi marrëdhënia e punës ka përfunduar më datë 05 Shkurt 2022.



11. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të pretendimeve të palëve, vlerësoi se prova e re, lista me emrave e 44 personave të depozituar në seancë dëgjimore nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” ti vihet në dispozicion përfaqësuesve të bashkisë Rrogozhinë, dhe brenda afatit 3 (tre) ditë përfaqësuesit e bashkisë Rrogozhinë duhet ti kthejnë përgjigje zyrtare pyetjeve të bëra nga z. Logu.
12. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të seancës dëgjimore nëpërmjet procesverbalit të nënshkruar nga zj. Elona Kaçani, vë në dispozicion listën me emrat e 44 punonjësve, ku pretendohet se janë punësuar në bashkinë Rrogozhinë, depozituar nga z. Logu.
13. Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet shkresës nr. 1216 prot., datë 25.03.2022, administruar me tonën nr. 1957 prot., datë 30.03.2022, vë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, materialet plotësuese mbi procedurën e rekrutimit të punonjësve sezonal, të punësuar pas datës së dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, aktet e emërimit të disa punonjësve të cilët kanë qenë më parë të punësuar si dhe kopje të kontratave të punës së punonjësve sezonal, të emëruar përpara datës së dekretimit të zgjedhjeve. Nëpërmjet shkresës nr. 2053 prot., datë 11.04.2022, shkresat e sipërcituara i janë dërguar për njohje subjektit zgjedhor denoncuese Partia Demokratike.
14. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2125 prot., datë 11.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës për gjykimin e çështjes objekt denoncimi, më datë 13 Prill 2022, ora 13:00, me palë Partia Demokratike, dhe bashkia Rrogozhinë. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” me përfaqësues të tij z. Marash Logu. Bashkia Rrogozhinë edhe pse ka marrë dijeni për njoftimin për zhvillimin e seancës nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk janë paraqitur në seancë. Z. Logu në fillim të seancës dëgjimore kërkoi të drejtën e fjalës për procedurë, duke kërkuar shtyrje të seancës për shkak se ende nuk ishte njohur me praktikën e plotë të bashkisë Rrogozhinë, vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas detyrës së lënë në seancën degjimore të datës 15 Mars 2022. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi pranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, duke shtyrë seancën e shqyrtimit të çështjes objekt denoncimi.
15. Në përfundim të afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi. Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, të Komisionit Rregullator “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 144,



datë 14 Prill 2022 “Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” për shkelje të parashikuar në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Rrogozhinë”, vendosi zgjatjen e afatit me 60 (gjashtëdhjetë) ditë të tjera.

16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2266 prot., datë 27.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës për gjykimin e çështjes objekt denoncimi, më datë 28 Prill 2022, ora 12:00, me palë Partia Demokratike, dhe bashkia Rrogozhinë. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” me përfaqësues të tij z. Marash Logu. Bashkia Rrogozhinë edhe pse ka marrë dijeni për njoftimin për zhvillimin e seancës nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk janë paraqitur në seancë. Në përfundimet e shpjegimeve të tij z. Logu i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative ndaj bashkisë Rrogozhinë në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, pasi sipas tij shkelja e ligjit është mjaftë e qartë. Gjithashtu, z. Logu pretendon se provat e depozituara nga bashkia Rrogozhinë më datë 25.03.2022 dhe të administruara në KQZ më datë 30.03.2022 nuk i përkasin objektit të hetimit të kësaj çështjeje, pasi janë kontrata dhe urdhëra për emërimin e disa përsoneve dhe kërkoi që të mos administrohen.

III. Analiza ligjore

17. Neni 91, pika 3, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: *“Gjate fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.*
18. Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, urdhri nr. 43, datë 21.01.2022, është nxjerrë në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale të institucionit, për marrjen e masave për përbalimin e situatave si pasojë e kushteve të motit, në përmbushje të detyrimit të kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Punësimi i përkohshëm i 27 (njëzetë e shtatë) punonjësve në bashkinë Rrogozhinë, nuk përfshihet në



parashikimet e nenit 91, pika 3 të Kodit Zgjedhor, për at kohë sa është diktuar nga nevoja për të përballuar situatat e vështira si pasojë e kushteve të motit si dhe punësimi është bërë pa filluar ende fushata zgjedhore. Marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga bashkia Rrogozhinë, referuar pikës 3, të urdhrit nr. 43 datë 21.1.2022, të kryetarit të bashkisë Rrogozhinë, marrëdhënia financiare e këtyre punonjësve është ndërprerë më datë 05.02.2022, përpara fillimit të fushatës zgjedhore. Me vendim të Komisionit Rregullator, fushata zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkië, të datës 6 Mars 2022, filloi me datën 19 Shkurt 2022.

19. Për sa më sipër, veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura. Në kuptim të nenit 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.
20. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2 dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, si dhe nenet 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

V E N D O S I:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj bashkisë Rrogozhinë.



Data: 19 Maj 2022

Nr. 166

“Për shqyrtimin e denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, ndaj bashkisë Rrogozhinë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

2. Moskonstatimin e shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
3. Rezultatet e këtij vendimi t’u njoftohen palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 19 Maj 2022

Nr. 166

“Për shqyrtimin e denoncimit të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, ndaj bashkisë Rrogozhinë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”